



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:291207

Datë: 27.09.2022

Numri i dokumentit: 03466474

P.nr.10/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj me bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh., Sh.,nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.3221/2019 të datës 22.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 19.09.2022, në të cilën prezent ishin prokurori i shtetit Jovo Radovic, i pandehuri Sh., Sh., si dhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra, më datën 19.09.2022 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 27.09.2022, e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

- I pandehuri **Sh., Sh.**, nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë (data e lindjes) fshatin ... - Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer katër (4) klasë të shkollës fillore, pensionist, i martuar-baba i fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

- **SEPSE** : Me datën 26.07.2019, rreth orës 23:00, në fshatin - Komuna Skenderaj, në shtëpinë familjare, i aftë që ta kuptojë rëndësinë e veprës se tij dhe të udhëhiqte me veprimet e veta, i vetëdijshëm për veprën e tij, ka dashur kryerjen e së njëjtës, dhe i vetëdijshëm se vepra është e kundërligjshme, në ahengun familjar në shenjë të gëzimit ka shkrepur disa të shtëna në ajër prej pistoletës të markës “...”, me gaz, me numër serik pra, ka përdorur armë në kundërshtim me Ligjin për armë Nr.05/L-022 të Republikës së Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, e lidhur me nenet 282 par.2, nënpar.2.1, 450 par.2 nënpar.2.6, 453 par.1 si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin :

- E G J Y K O N -

I.- Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë nuk do të kryejë vepër tjetër penale.

II.- Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro) si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.- Gjukata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga nenin 367 par.3 të KPRK-së, urdhëron konfiskimin e përhershëm të armës-pistoletës automatike me gas, t, të kalibrit 9 mm Gas, me numër serik EJC..., e cila armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, nëse vërtetohet së e njëjta nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur.

IV.- Kërkesë pasurore – juridike sipas aktakuzës nuk kishte.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm më datë 12.01.2022 në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3221/2019 të datës 22.12.2021 ndaj të pandehurit Sh., Sh., nga fsh....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

- Gjukata në këtë çështje penale më datë 19.09.2022 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent prokurori i shtetit Jovo Radoviq, i pandehuri Sh., Sh., si dhe përkthyesi i gjykatës Sh., H.,, ashtu që të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale dëshiron të mbrohet vetë.

- Vlerësimi i pranimi të fajësisë -

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit shtetit lidhur me aktakuzën, gjykata të pandehurin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficionet e pranimi të fajësisë, ashtu

që i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsërisë veprimet e tilla dhe në fund kërkoi nga gjykata që t'i shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë duke theksuar se nuk e ka ditur se veprimet e tij janë në kundërshtim me ligjin, mosha e tij e shtyer ashtu që, lidhur me këto veprime ka theksuar se është penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkoi falje.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e kërkoi mendimin nga prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që ta aprovoj këtë pranim fajësie gjithashtu kërkoi që gjykata të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese moshën e tij të shtyre dhe së deri me tani asnjëherë nuk ka qenë i dënuar me asnjë vepër penale dhe kjo të vlerësohet me rastin e shqiptimit të sanksionit penal ndaj tij.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par.4 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

- Gjendja faktike e vërtetuar -

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të pandehurin, siç ishin : Raporti i oficerit policor me Nr.të rastit 2019-BF-0135 e datës 26.04.2019, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit-Sh., Sh., Nr.2019-BF-0135 i datës 27.04.2019, lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Vërtetimi mbi konfiskimin e pasurisë Nr., e datës 26.04.2019 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes gjithsej dy (2) faqe së bashku me fotoalbumin gjithsej gjashtë (6) faqe Nr.... të datës 26.04.2019 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë - Njësia e Forenzikës, Raporti i Ekspertizës AKF/2019-0328 i datës 02.10.2019 lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, si dhe nga vështrimi në foto dokumentacionin dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, gjykata vërteton në tërësi elementet inkriminuese të tij, ashtu që përtej çdo

dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale-Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sepse me datën 26.07.2019, rreth orës 23:00, në fshatin-Komuna Skenderaj, në shtëpinë familjare, i aftë që ta kuptojë rëndësinë e veprës së tij dhe të udhëhiqte me veprimet e veta, i vetëdijshëm për veprën e tij, ka dashur kryerjen e së njëjtës, dhe i vetëdijshëm se vepra është e kundërligjshme, në ahengun familjar në shenjë të gëzimit ka shkrepur disa të shtëna në ajër prej pistoletës të markës “....”, me gaz. Me numër serik EJC-..., pra ka përdorur armë në kundërshtim me Ligjin për armë nr.05/L-022 të Republikës së Kosovës, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit -

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike pastaj, moshën e tij të shtyer ... (...) vjeçar, baba i nëntë ..., ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, pastaj pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, ndërsa gjykata rrethanë rënduese në rastin konkret për të pandehurin gjeti dashjen direkte të tij të kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, kontributin esencial të tij në këtë vepër penale.

- Me rastin e matjes së dënimit për të pandehurin, gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nënpar. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 72 par.1, nënpar. 1.5 të KPRK-së, vendosi që të zbutë dënimin duke marrë parasysh rrethanat personale se i njëjti është i moshës së shtyer ... (..) vjeçar, baba i nëntë (...., pastaj pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur për këtë vepër penale si dhe pranimin në tërësi të fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar.

- Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me kusht ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

- Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë

gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për konfiskim -

- Duke u bazuar në nenin 367 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 282 par.1, nënpar.2.1 të KPP-së, ka Urdhëruar konfiskimin e përhershëm të armës-pistoletës automatike me gas, ...të kalibrit 9 mm Gas, me numër serik EJC-..., e cila armë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, nëse vërtetohet së e njëjta nuk është përdorë në ndonjë rast tjetër të hapur pasi që, e njëjta është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale, gjithashtu e njëjta është rezultat i kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, për të cilën u shpallë fajtores dhe iu shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Meqenëse kërkesë pasurore-juridike sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit nuk kishte, gjykata për këtë çështje nuk vendosi fare.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

**- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.10/2022 me datë 27.09.2022.**

**Procesmbajtësja,
Florije Gucati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdiqaj**

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.